




This project is co-funded
by the European Union



TË DREJTAT E MIA: TË DREJTAT E NJERIUT DHE AFTËSIA E PUNËS



ecim rritemi së bashku



TË DREJTAT E MIA

Teksti është përpiluar në bazë të publikimit
“ Të drejtat e Mia: të Drejtat e Njeriut, dhe Aftësia e Punës”
Versioni original i këtij materiali, është publikuar
nga Shoqata për Vetëpërfaqësim.
Kjo shoqatë është shoqata e parë e personave me aftësi të
kufizuar intelektuale në Republikën e Kroacisë.
Shoqata “Ndihmoni Jetën” falenderon shoqatën, që e ka bërë të
mundur përdorimin e këtij materiali.

Për përgatitjen e broshurës janë përdorur vizatime dhe simbole **Widgit Symbols©**
Widgit Software 2002-2017
Web-faqja: www.widgit.com

Vizatimet dhe simbolet e përdorura në këtë broshurë janë
pronësi e Widgit Software dhe nuk mund të përdoren pa lejen e pronarit.

Përkthyer në gjuhën shqipe nga: Kosovo Mental Disability Rights Initiative, K-MDRI
dhe Përshtatur nga Shoqata “Ndihmoni Jetën”


Të gjitha shprehjet dhe emërtimet gramatikore mashkullore
të përdorura në këtë tekst përfshinë gjininë mashkullore dhe
femërore të personave që ju referohen.

Ky publikim u ribotua në kuadër të projektit “Të rinjtë me aftësi të kufizuar intelektuale,
advokojnë për përfshirjen e tyre sociale”, i bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian dhe
zbatuar nga World Vision Shqipëri, SEEYN dhe Shoqata Ndihmoni Jetën.

Ky publikim është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian.
Përmbajta e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e autorëve dhe nuk pasqyron
detyrimisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

Hyrje

Nëpërmjet kësaj broshure dëshirojmë t'ju bëjmë të ditura të drejtat tuaja.



Në broshurë do të shpjegojmë çfarë janë aftësitë e punës dhe të drejtat e personave që u është hequr e drejta për punë thjesht nga aftësitë.

Në broshurë ka shumë shembuj të të drejtave që lidhen me aftësitë e punës.

Në broshurë do të shpjegojmë në mënyrë të veçantë të drejtën për punë.

Do të shpjegojmë se si lidhen aftësia e punës me të drejtën për punë.

Në fund të broshurës do të shpjegojmë se cilat janë detyrat e kujdestarit tënd dhe çfarë mund të bësh nëse kujdestari yt nuk përmbush detyrat që ka ndaj teje.

Shpresojmë që shumë gjëra në këtë broshurë t'ju hyjnë në punë dhe të jenë interesante.


Ç'do të thotë të kesh të drejta?

Të kesh të drejta do të thotë që ti mund të vendosësh dhe mund të bësh diçka vet.



Për shembull:

- Të vendosësh se ku do të jetosh, do të thotë se ke të drejtë të zgjedhësh vet vendin ku do të jetosh.
- Të shpenzosh paratë e tua si të duash, do të thotë se ke të drejtë të vendosësh ti për paratë e tua.
- Të vendosësh me kë do të shoqërohesh, do të thotë se ke të drejtë ti të zgjedhësh shokët e tu.



Të kesh të drejta do të thotë, gjithashtu, se mund të kërkossh nga të tjerët të bëjnë diçka për ty.



Për shembull:

- Nëse të sulmon dikush, mund të kërkossh nga polici të të mbrojë.
- Nëse dikush të mashtron, ke të drejtë të kërkossh nga gjykata ta gjykojë.
- Nëse të dhemb diku, ke të drejtë të kërkossh nga mjeku të të shërojë.



Cilat janë detyrat apo detyrimet

Detyrat janë gjërat që duhet të bësh për të pasur disa të drejta.

Për shembull:

- Ke detyrim të fitosh para, që të kesh të drejtën të shpenzosh para.
- Ke detyrim të kesh librezën shëndetësore, që të kesh të drejtën të marrësh ndihmën e mjekut.
- Ke detyrim të blesh biletën, që të kesh të drejtën të udhëtosh.



Detyrat apo detyrimet, shpesh janë të lidhura me të drejtat.

Shumë të drejta mund të kesh, vetëm nëse më parë ke kryer detyrat.




Është me rëndësi të dihet se:



Të gjithë njerëzit kanë të drejta.

Gjithmonë duhet pasur kujdes, që me të drejtat e tua të mos shkelësh të drejtat e tjetrit. Askush nuk ka të drejtë të shkelë të drejtat e tjetrit.



Gjithashtu, Njerëzit e tjerë, nuk kanë të drejtë të shkelin të drejtat e tua.



Çfarë është aftësia për punë

Aftësia për punë është shumë e rëndësishme për të drejtat e çdo njeriu. Aftësia për punë do të thotë se vet mund të realizosh të drejtat e tua dhe të kryesh detyrimet e tua.



Për shembull:

- Nëse ke aftësi për punë, ke të drejtë të vendosësh vet se si do t'i shpenzosh paratë e tua.




- Nëse ke aftësi për punë, ke të drejtë të vendosësh vet nëse dëshiron të martohesh apo jo.



- Nëse ke aftësi për punë, ke të drejtë të vendosësh vet se ku do të jetosh.



- Nëse ke aftësi për punë, ke të drejtë të vendosësh vet se kujt do t'ia lësh trashëgim pasurinë pas vdekjes.



Për këto dhe shumë të drejta të tjera, njerëzit mund të vendosin vet, në mynyrë të pavarur, vetëm nëse kanë aftësinë për punë.





Kush vendos për aftësinë tënde për punë

Për aftësinë tënde për punë vendos gjykata.

Qendra për punë sociale nis procedurën për heqjen e aftësisë për punë në gjykatë.

Në procedurën për heqjen e aftësisë për punë, gjykata mund të gjykojë në tri mënyra:

- Gjkata mund ta gjykojë se personit nuk duhet t'i hiqet aftësia për punë. Kjo do të thotë se personi ka të drejtë të vendosë vet për të drejtat dhe detyrat e tij.
- Gjkata mund të gjykojë se personit duhet t'i hiqet pjesërisht aftësia për punë. Kjo do të thotë se gjykata përcakton saktësisht se për çfarë personi mund të vendosë vet. Për të gjitha gjërat e tjera vendos kujdestari.
- Gjkata mund të gjykojë se personit duhet t'i hiqet në tërësi aftësia për punë. Kjo do të thotë që gjykata i jep kujdestarit të drejtën për të vendosur për personin që i është hequr tërësisht aftësia për punë.




Nëse mendon se vendimi i gjykatës është i padrejtë, ke të drejtë të ankohesh ndaj vendimit.



Nëse vendos të ankohesh ndaj vendimit të gjykatës, më e mira është t'i drejtohesh avokatit.



Ç'do të thotë të të hiqet aftësia për punë?



Personat, të cilëve u është hequr aftësia për punë, vendosen nën kujdestari dhe pajisen me një kujdestar.



Heqja e aftësisë për punë, do të thotë se nuk mund të vendosësh vet për të drejtat dhe detyrimet tuaja.

Nëse të është hequr aftësia për punë, për të drejtat dhe detyrimet tuaja përkujdeset kujdestari.

Kjo do të thotë se kujdestari ka të drejtë të marrë shumë vendime për jetën tënde.



Për shembull:

- Kujdestari ka të drejtë të vendosë se ku do të jetosh.
- Kujdestari ka të drejtë të vendosë se si do të shpenzosh të hollat e tua.
- Kujdestari ka të drejtë të vendosë për shërimin tënd.
- Kujdestari ka të drejtë të vendosë nëse do të martohesh.



Çfarë të drejtash nuk ke, nëse të është hequr aftësia për punë



Nëse të është hequr aftësia për punë tërësisht, nuk mund të kesh këto të drejta:

- E drejta për të marrë pjesë në zgjedhje.
Nëse të është hequr aftësia për punë tërësisht, nuk ke të drejtë të votosh në zgjedhje.
- E drejta për organizim
Nëse të është hequr aftësia për punë tërësisht, nuk ke të drejtë të themelosh



shoqatë dhe as të jesh anëtar i një shoqate.

- Nënshkrimi i marrëveshjeve
Nëse të është hequr aftësia për punë tërësisht, nuk vlen asnjë marrëveshje që nënshkruan ti vet.



- Nuk mund të veprosh vet me paratë e tua
Nëse të është hequr aftësia për punë tërësisht, nuk ke të drejtë të hapësh llogari në bankë vet dhe të veprosh lirshëm me paratë në llogarinë tënde.



- E drejta për martesë
Nëse të është hequr aftësia për punë tërësisht, nuk mund të vendosësh vet për martesën tënde.



Ekzistojnë edhe të drejta të tjera të cilat nuk mund t'i realizosh, nëse të është hequr aftësia për punë tërësisht.

Disa nga këto të drejta prapë mund t'i realizosh, por vetëm me ndihmën e kujdestarit apo gjykatës.



E drejta për punë

E drejta për punë është një e drejtë e rëndësishme e njeriut.

Njerëzit dëshirojnë të punojnë, që të fitojnë rrogën.



Me paratë që fitojnë, njerëzit mund të blejnë ato që u nevojiten për jetë.



Në punë njerëzit mund të tregojnë se janë anëtarë të vlefshëm dhe të respektuar të shoqërisë.

Ka punë të ndryshme.

Njerëzit mund të punojnë në fabrika, zyra, tregje, punëtori, ofiçina, banka dhe në shumë vende të tjera.



Secila punë është e çmueshme.


Në secilën punë njeriu duhet të mundohet ta kryejë me ndershmëri detyrën e tij.

Njeriu ka të drejtë të marrë rrogën për punën që bën.



Ç'është diskriminimi

Diskriminim do të thotë që dikush sillet ndaj teje më keq se me të tjerët.



Me diskriminimin mund të përballesh kur
kërkon punë apo kur punësohesh.


Ç'është diskriminimi kur kërkon punë?

Paragjykimi ose dyshimi nëse ti di ta kryesh
mirë atë punë apo jo. Ndërkohë që atë punë ti
mund ta kryesh njëloj sikurse dhe personat e
tjerë, pa ndonjë aftësi të kufizuar.



Një ditë, dëgjon se një kompani kërkon punëtor,
për një punë të cilën ti di ta kryesh mirë.

Shkon tek kompania që kërkon punëtor dhe u
thua se do të dëshiroje të punësoheshe atje.



Por sapo paraqitesh, kompania vendos që në
atë vend pune, për të cilin ti je lajmëruar, të
punësojë një person tjetër, pa aftësi të kufizuara.
Nëse kjo të ka ndodhur ndonjëherë, do të thotë
se ti ke përjetuar diskriminim në kërkim të
punësimit.




Kur punëdhënësi nuk dëshiron të të punësojë,
vetëm sepse je person me aftësi të kufizuara
mendore, do të thotë se punëdhënësi të ka
diskriminuar.

Punëdhënësi nuk ka të drejtë të të largojë nga
puna vetëm për arsye se je person me aftësi të
kufizuara.




Kjo është e ndaluar me ligj.

Ç'është diskriminimi në punë? Diskriminim në punë do të thotë që njerëzit me të cilët punon, sillen më keq me ty se sa me punëtorët e tjerë, kjo vetëm sepse je person me aftësi të kufizuara mendore.




Diskriminimi në punë është kur personat me të cilët punon, të ofendojnë ose të thërrasin me emra fytes, sepse ti je person me aftësi të kufizuara mendore. Diskriminimi në punë është edhe kur për punë të njëjtë dhe punë të barabartë, merr rrogë më të vogël se sa punëtorët pa aftësi të kufizuara.



Në ligj shkruhet se njerëzit nuk duhen diskriminuar kur kërkojnë punë, apo kur punësohen dhe fillojnë punë.



Nëse ti ke përjetuar diçka të tillë, mund të njoftosh prindërit, kujdestarin, qendrën për mirëqënie sociale apo shokët.



Ata duhet të të ndihmojnë, nëse dikush të diskriminon.

Punësimi dhe Kontrata e punës

Thamë që puna është e rëndësishme për çdo njeri.




Personi që punon mund të tregojë se është i dobishëm.




Personi që punon mund të fitojë rrogën dhe kështu t'i sigurojë vetes paratë për jetën.



Personi që punon mund të njoftojë edhe shumë shokë të tjerë për punë.



Personat që nuk punojnë, nuk mund t'i bëjnë këto që përmendëm më sipër.



Si punësohen njerëzit?

Njerëzit punësohen duke nënshkruar fillimisht kontratën për punë.

Kontrata për punë lidhet mes punëtorit dhe punëdhënësit.



Në kontratën për punë, shkruhen të drejtat dhe detyrimet e punëtorit dhe punëdhënësit.



Të drejtat dhe detyrat e punëtorit

Të drejtat e punëtorit tregojnë se çfarë të drejtash ka punëtori në punë. Për shembull:

- Punëtori ka të drejtë të marrë rrogën për punën e vet.
- Punëtori ka të drejtë për pushim gjatë punës.



- Punëtari ka të drejtë për pushim vjetor.
- Punëtari ka të drejtë mbrojtjen e dinjitetit të vet. Kjo do të thotë se punëtari në punë nuk duhet të diskriminohet (përbuzet).
- Punëtari ka të drejtë të anëtarësohet në sindikatë dhe në këtë mënyrë të luftojë për të drejtat e tij.




Detyrimet e punëtorit tregojnë se si duhet të sillet punëtari dhe çfarë duhet të bëjë në punë.



Për shembull:

- Punëtari duhet ta kryej punën e tij me ndërgjegje dhe me kujdes. Kjo do të thotë që punëtari duhet të vijë në punë në orarin e caktuar dhe t'i kryej detyrat e tij me dëshirë.
- Punëtari duhet t'i tregojë punëdhënësit nëse dëshiron të punësohet edhe në një vend tjetër të punës.
- Punëtari nuk duhet të punojë kundër interesave të punëdhënësit të tij.



Të drejtat dhe detyrat e punëdhënësit


Punëdhënësi që të ka punësuar, ka të drejtë të kërkojë nga ti që:

- Të kryesh punën tënde me kujdes dhe pasion.
- Të vish në punë në orar.
- Të mos punosh edhe në ndonjë vend tjetër të punës.
- Të shkosh në shkollë apo në kualifikime, ta kryer punën tënde sa më mirë.




Punëdhënësi tek i cili punon, ka këto detyrime ndaj teje:

- Të të mundësojë që në punën tënde të jesh i sigurt. Kjo do të thotë se punëdhënësi duhet të bëj gjithçka është e mundur, që në punë të mos dëmtohesh apo vritesh.
- Punëdhënësi duhet që për punën tënde, të të paguaj rrogën sic është percaktuar në kontratën e punës një herë në muaj.
- Përveç rrogës, punëdhënësi është i detyruar të të paguaj kontributet për sigurimin shëndetësor dhe shoqëror (pension).
- Punëdhënësi ka detyrim të të sigurojë mbrojtjen nga përçmimi apo nënvlerësimi në punë. Kjo do të thotë se punëdhënësi duhet të ndalojë nënvlerësimin e punëtorëve të tjerë në punë ndaj teje.




Punësimi i personave me aftësi të kufizuar mendore


Thamë se kur punësohesh, duhet të nënshkruash kontratën me punëdhënësin.



Thamë edhe se personat që u hiqet aftësia për punë, nuk i kanë disa të drejta.



Personat që u është hequr aftësia për punë, nuk kanë të drejtë të nënshkruajnë vet kontratën e punës.



Nëse të është hequr aftësia për punë, kontrata jote vlen vetëm nëse është dakord kujdestari yt.



Për këtë, personat të cilëve u është hequr aftësia për punë, e kanë shumë të vështirë të punësohen dhe të marrin kontratë pune.

Shumë kujdestarë nuk dëshirojnë të bien dakord me kontratën e punës për të mbrojturin e tyre.

Ka kujdestarë e punëdhënës që mendojnë se personat, të cilëve u është hequr aftësia për punë, nuk duhet të punojnë.



Shumë njerëz mendojnë se personat, që u është hequr aftësia për punë, mund të punojnë vetëm në ambient pune të mbrojtur. Kjo nuk është e saktë.




Personat, që u është hequr aftësia për punë, kanë edhe një problem.

Edhe nëse arrijnë të punësohen, nuk mund të përdorin vet rrogën e tyre. Kjo do të thotë që të tjerët vendosin se si do të shpenzohen paratë e rrogës së tyre.



Çfarë mendon Shoqata Ndishmoni Jetën për të drejtën në punë?


Në Shoqata Ndishmoni Jetën mendojmë se të gjithë njerëzit duhet të kenë të drejta të barabarta në punë.



Mendojmë se nuk është e drejtë që personat, të cilëve u hiqet aftësia për punë, mund të punojnë vetëm në ambjent pune të mbrojtur.



Personat, të cilëve u është hequr aftësia për punë, kanë të drejtë për punë dhe dëshirojnë të punojnë si të gjithë njerëzit e tjerë.



Mendojmë se nuk është e drejtë që të tjerët të veprojnë me paratë që ne fitojmë. Personat, të cilëve u është hequr aftësia për punë, dëshirojnë që vet të vendosin se si do ta shpenzojnë rrogën e tyre.



Çfarë mendon Shoqata Ndihamoni Jetën për aftësinë për punë?

Në Shoqata Ndihamoni Jetën mendojmë se heqja e aftësisë për punë nuk është e drejtë. Personave që u hiqet aftësia për punë u kufizohen shumë të drejta.



Shoqata Ndihamoni Jetën bën thirrje që njerëzve të mos u hiqet aftësia për punësim. Mendojmë se, çdo person duhet të vendosë sa më shumë për vete dhe për jetën e tij.



Kërkojmë që njerëzit të kenë përkrahje apo ndihmë që të mund të vendosin sa më shumë për vete.

Përkrahje do të thotë që dikush të ndihmon dhe të këshillon të marrësh vendime sa më të mira.




Mendojmë se nuk është e drejtë që të tjerët të vendosin për veten tonë.

Çdo njeri ka të drejtë të drejtojë jetën e tij dhe të marrë vendimet e veta.

E dimë se në Shqipëri shumë personave me aftësi të kufizuara mendore u është hequr aftësia për punë dhe kanë kujdestarë.



Për këtë, në vazhdim, do të ju shpjegojmë të drejtat e personave që u është hequr aftësia për punë dhe detyrat e kujdestarëve të tyre.




Detyrat e kujdestarit ndaj teje

Nëse të është hequr aftësia për punë, kujdestari ka një rol të madh në jetën tënde. Për këtë, kujdestari duhet të sillet mirë dhe me kujdes ndaj teje.

Kujdestari nuk mund të vendosë vet për të drejtat e tua.


Ai duhet të diskutojë me ty sa herë i duhet të vendosë për të drejtat e tua.



Ti ke të drejtë t'i tregosh të gjitha dëshirat e tua kujdestarit tënd.

Për shembull:

- Ku ke dëshirë të jetosh,
- Çfarë pune dëshiron të bësh,
- Si dëshiron t'i shpenzosh paratë e tua,
- Çfarë rrobash dëshiron të blesh,
- Ku dhe si dëshiron të marrësh ndihmën mjeksore,
- A dëshiron të martohesh,
- A dëshiron të kesh librezë të kursimeve.




Kujdestari duhet të dëgjojë dhe të respektojë dëshirat tuaja.

Me kujdestarin duhet të takohesh rregullisht. Kjo do të thotë që kujdestari duhet t'ju vijë për vizitë shpesh, nëse nuk jetoni së bashku. Kujdestari duhet të sigurojë që ti mund të shkosh për vizitë tek ai, sa herë që dëshiron.



Megjithatë, kujdestari nuk mund të vendosë gjithmonë ashtu si dëshiron ti.

Kur kujdestari vendos ndryshe nga sa dëshiron ti, duhet të të shpjegojë se pse nuk ta ka plotësuar dëshirën.



Kujdestari duhet të përmbushë detyrimet e veta ndaj teje.


Kur kujdestari nuk përmbush detyrimet e veta ndaj teje?

Kujdestari nuk përmbush detyrimet ndaj teje nëse me ty sillet ashpër dhe në mënyrë të pakujdesshme.



Sjellja e ashpër dhe e pakujdesshme e kujdestarit ndaj teje, do të thotë:



- Që kujdestari nuk pyet fare se çfarë dëshiron ti, por vendos vet, për çdo gjë, mbi jetën tënde,
- Që kujdestari nuk pyet fare se çfarë dëshiron ti, por vendos vet, gjithçka, mbi paratë tuaja,



- Që kujdestari nuk të vjen për vizitë ty, ose të ndalon që ti ta vizitosh atë,
- Që kujdestari nuk dëshiron të të plotësojë qoftë edhe dëshirat më të vogla,
- Që kujdestari, pa asnjë arsye dhe shpjegim, t'i ndalon gjërat që ti i do apo të pëlqejnë,
- Që kujdestari të ndalon të flasësh me njerëzit e tjerë, për gjërat që nuk je i kënaqur,
- Që kujdestari të bërtet,
- Që kujdestari të rreh.



Nëse kujdestari sillet në këtë mënyrë me ty, do të thotë se ai nuk i plotëson detyrat që ka ndaj teje.

Ti ke të drejtë të shkosh në qendrën për mirëqenie sociale dhe të ankohesh për punën e kujdestarit tënd.



Nëse nuk je i kënaqur me punën e kujdestarit tënd, ke të drejtë të kërkojsh nga qendra për mirëqenie sociale të të caktojë një kujdestar tjetër.

Qendra për mirëqenie sociale duhet të mbrojë të drejtat e tua dhe të kujdeset që kujdestari yt të përmbushë detyrat e tij.



Është me rëndësi të dini:




Edhe nëse të është hequr aftësia për punë, ke të drejtë të vendosësh ti për jetën tënde.



Kujdestari nuk mund të vendosë vetëm për jetën tënde.

Kujdestari duhet që gjithmonë të dëgjojë çfarë mendon dhe dëshiron ti, kur vendos për jetën tënde.



Kujdestari duhet të të shpjegojë sa më mirë çdo vendim që merret për ty dhe jetën tënde.



Për këtë, ti dhe kujdestari yt duhet të shkoni për vizitë tek njëri tjetri dhe të bisedoni për të gjitha vendimet që merr për ty dhe jetën tënde.



Kujdestari që nuk realizon këto detyrime nuk sillet përgjegjshëm ndaj teje.

Ti ke të drejtë të kërkojsh:

- Nga gjykata që ta kthejë aftësinë për punësim,
- Nga qendra e mirëqenies sociale të të ndërrojë kujdestarin.



Ke të drejtë të ankoresh:

- Ndaj gjykatës, për vendimin me të cilin gjykata të heq aftësinë për punë,



- Ndaj qendrës për mirëqenie sociale, për punën e kujdestarit tënd.

Gjykatës apo qendrës për mirëqenie sociale duhet t'i drejtohesh vet.

Nëse nuk di si t'i drejtohesh gjykatës apo qendrës për mirëqenie sociale, mund të kërkesësh ndihmë.



Për ndihmë mund të pyesësh këta persona:

- Prindërit, të afërmit, shokët
- Kujdestarin tënd,
- Avokatin,
- Punëtorin social.



Nëse dëshiron këshillë apo ndihmë, mund t'u drejtohesh edhe shoqatave që ndihmojnë personat me aftësi të kufizuara mendore, të cilëve u është hequr aftësia për punë.



